



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PRRENJAS

Nr 2380 prot.

Prrenjas, më 02.09.2022

**NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE**

**PËR POZICIONET E PUNËS:  
PSIKOLOG  
FIZIOTERAPIST  
LOGOPEDIST  
PUNONJËS SOCIAL**

Në kuadër të Projektit "Qendër Komunitare për Shërbime ndaj Aftësisë së Kufizuar" në Bashkinë Prrenjas, financuar nga Bashkimi Europian dhe zbatuar nga World Vision në bashkëpunim me bashkinë Prrenjas, lind domosdoshmëria për shpalljen e vendeve të lira të punës për pozicionet si më poshtë vijon:

**1- Psikolog me kohë të plotë**

**Qëllimi i Vendit të Punës**

Psikologu në këtë vend pune është përgjegjës për dhënien e shërbimeve psikologjike të tilla si vlerësimi psikologjik, këshillimi dhe terapia e në të njëjtën kohë do të ofrojë konsulta dhe këshilla në mbështetje të kujdesit psikologjik, sjelljes dhe mirëqenies e zhvillimit të fëmijës me aftësi të kufizuar dhe familjes së tij. Ai do të punojë si pjesë e ekipeve me profesionistë të tjerë në hartimin dhe zbatimin e planit individual të fëmijës duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në sjelljen dhe përjetimin emocional të fëmijës dhe familjes, duke përdorur strategji ndërhyrjeje në përputhje me vlerësimin e kryer.

**Detyrat dhe Përgjegjësitë**

- Vlerëson aspektet konjitive, emocionale, sociale, ndërpersonale, nivelin e pavarësisë, aftësive të vetë ndihmës dhe funksionimin në komunitet të individit, në përputhje me kriteret e ICF-së dhe etikën e standardet në vlerësim.
- Diagnostikon, ekzaminon çrregullimet dhe vonesat zhvillimore në bashkëpunim me profesionistët e tjerë.
- Kryen vlerësime të ecurisë/progresit të fëmijës.
- Kryen vlerësime të familjes për të identifikuar nivelin e përshtatjes, përballimit dhe stresit tek familja, stilin e komunikimit të prindërve/personit kujdestar dhe cilësinë e marrëdhënies, stilet e

përballimit të situatës nga prindi, përgjigjes emocionale dhe përballimit të vëllezërve dhe motrave, nivelit të mbështetjes së prindit, shëndetin mendor dhe fusha të tjera të ngjashme.

- Bën vlerësim të sjelljes funksionale të fëmijës. Në bazë të këtij vlerësimi harton ndërhyrjet për sjelljet sfiduese.
- Harton planin e zhvillimit personal dhe planin e zhvillimit të familjes në bashkëpunim me ekipin dhe profesionistë të tjerë.
- Kryen konsulta/këshillime me vetë fëmijët, stafin, familjen, si dhe personat e entitetet e interesuara.
- Realizon ndërhyrje dhe punë të drejtpërdrejtë terapeutike duke përdorur strategji të ndryshme trajtimi për rritjen e vetë vlerësimit, vetë kontrollit, pavarësisë personale si dhe mirëqenien psikologjike të fëmijës.
- Mbështet dhe nxit sjelljen pozitive të fëmijës përmes programeve/strategjive të mbështetjes së sjelljes.
- Zhvillon programe për individë dhe grupe që synojnë reduktimin e izolimit, nxitjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve, trajnimin e aftësive si dhe programe të tjera të ngjashme në dobi të fëmijës, familjes dhe komunitetit.
- Mbështet familjen e fëmijës duke punuar direkt me familjen dhe persona të tjerë të rëndësishëm në jetën e fëmijës duke i ndihmuar të kuptojnë nevojat emocionale dhe sociale të fëmijës, të njohin nivelin zhvillimor të tij, reduktimin e izolimit të familjes, mundësi për të mbështetur vëllezërit dhe motrat, fuqizim të familjes për të kërkuar të drejtat e veta, si dhe krijimin e lidhjeve me persona të interesuar (vullnetarët).
- Mbështet realizimin e aktiviteteve psiko sociale në dobi të gjithëpërfshirjes së fëmijës me aftësi të kufizuar në komunitet.

#### **Vlerësime specifike të fushës**

- Kryen teste inteligjence për përcaktimin e koeficientit të inteligjencës.
- Kryen teste të vizatimit për përdorues të vecante.
- Kryen teste vizualo-motore për vlerësimin e aftësive shkollore.
- Bën teste psikologjike për persona me probleme të rënda emocionale.

#### **Ofron trajtimin terapeutik dhe psikoterapeutik për përfituesit e shërbimit**

- Ofron teknika të trajtimit terapeutik për përdoruesit në baze të PEI në fushën e konjicionit, të problemeve psikoemocionale dhe probleme të sjelljes.
- Kryen këshillim psikologjik.
- Kryen mbështetje emocionale për përdorues që e kanë të nevojshme.
- Nderhyn në situata të sjelljes ekstreme nga përdorues të ndryshëm.
- Jep teknika dhe terapi për modifikimin e sjelljeve jo të përshtatshme.

## **Kualifikimet dhe Cilësitë e Punonjësit**

- Diplomë e nivelit master në degën e psikologjisë;
- Të paktën 3 vite përvojë në profesion (punë klinike ose shërbime psiko sociale);
- Të jetë i licensuar nga Urdhri i Psikologut;
- Gëzon integritet individual dhe profesional si dhe pjekuri emocionale;
- Aftësi të mira planifikuese dhe organizative, negociuese dhe në zgjidhjen e konfliktit;
- Aftësi të mira interpersonale e i aftë të punojë me grupe të ndryshme njerëzish në mënyrë profesionale dhe etike;
- Njohuri/përvojë/trajnime mbi Terapine e sjelljes së Aplikuar, Terapine e Zhvillimit dhe të Lojes (e preferueshme);
- Ka respekt për të drejtat themelore, dinjitetin e fëmijës dhe familjes;
- Ka pasion për punën dhe ndihmën ndaj njeriut;
- Njohuri të mira për të drejtat e fëmijës dhe çështje të mbrojtjes së fëmijës;
- Patentë të klasit B dhe të jetë i gatshëm të ngasë makinën (e preferuar).

## **Kushtet e Punës**

### *Vendi dhe koha e punës*

Punonjësi do të punojë në bashkinë e Prrenjasit . Në përputhje me Kodin e Punës, java e tij e punës është 40 orë, nga dita e hënë në të premte. 80% e kohës së punës do të jenë në duke ofruar terapi në qendren komunitare dhe 20% në aktivitete të tjera në funksion të përmbushjes së detyrës.

*Kohegjatja e kontratës: 22 muaj*

*Data e synuar për fillimin e punës: 1 Tetor 2022*

### *Sfidat e pozicionit të punës*

Punonjësi në këtë pozicion pune do të punojë me fëmijë dhe familje që paraqesin vështirësi/sfida të ndryshme ndaj është e nevojshme të dijë të krijojë marrëdhënie pozitive profesionale me të gjithë përdoruesit/përfituesit e shërbimit të të gjitha moshave, të jetë personalitet i duruar e i kujdesshëm, si dhe të dijë të aplikojë aftësitë e tij në zgjidhjen e problemeve dhe situatave të paparashikuara.

### *Kontaktet dhe ndërveprimi*

Punonjësi në këtë pozicion pune, në përmbushje të detyrës së tij do të jetë në kontakt/ndërveprim të përditshëm me fëmijët /familjarët e fëmijës, kolegët e ekipit të qendrës dhe atij lëvizës si dhe do të jetë në kontakt të vazhdueshëm me Bashkinë e Prrenjasit dhe World Vision.

80% e kohës së punës do të jenë në qendër dhe 20% në terren kur lind nevoja për vizita në familje, shkolla apo për të marrë pjesë në trajnime apo mundësi rritjeje profesionale.

### *Niveli i përgjegjësisë financiare*

Në këtë pozicion pune, punonjësi ka rol konsultues dhe raporton për nevojën e blerjeve dhe shpenzimeve të ndryshme në dobi të fëmijëve dhe familjeve tek personi përgjegjës.

### **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

Kandidati duhet të dërgoje me postë ose dorazi në Sektorin e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Prrenjas, dokumentet e dosjes së tij personale si më poshtë:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- CV;
- Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një Universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë atë të njehsuar pranë Ministrisë përgjegjëse për Arsimin;
- Fotokopje e listës së notave. Nëse ka një diplomë dhe një listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në shtetin Shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë atë të konvertuar sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e librezës së punës;
- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Deklaratë me shkrim se kandidati nuk është denuar me vendim të formës së prerë nga gjykata dhe nuk ka qënë në ndjekje penale nga prokuroria;
- Vërtetim i gjendjes mjekësore.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në letrën e motivimit.

### **2. Fizioterapist me kohë të plotë**

Fizioterapisti në këtë vend pune është përgjegjës për dhënien e shërbimeve fizioterapeutike për fëmijët me aftësi të kufizuar në qendrën komunitare. Puna e fizioterapistit do të konsistojë kryesisht në vlerësimin e nevojave fizioterapeutike të fëmijës si dhe realizimit të ndërhyrjeve dhe trajtimeve fizioterapeutike për fëmijët me spektër të gjerë crregullimesh. Fizioterapisti ka për detyrë kryesisht të reduktojë deficitet motorike të lindura ose të fituara gjatë fëmijërisë së hershme apo gjatë moshës së rritur. Nëse deficitet motorike shoqërohen dhe me deficite mendore, terapia është e kombinuar dhe quhet terapi psikofizike.

Ai/ajo do të japë informacion dhe udhëzojë familjarët, kolegët e ekipit dhe entitete të tjera të interesuara mbi mënyrën e menaxhimit fizioterapeutike të fëmijës me aftësi të kufizuar. Si fizioterapist i ekipit në Qender ai do të kontribuojë në fushën e tij të përgjegjësisë për hartimin dhe ndjekjen e planit individual të fëmijës me aftësi të kufizuar dhe do të japë kontributin e tij në zhvillimin dhe promovimin e shërbimit të këtyre ekipive.

Fizioterapisti duhet të ketë edukim special në fushën që mbulon. Ai/ajo duhet të njohë mirë anatominë dhe fiziologjinë e funksionimit të trupit të njeriut. Gjithashtu duhet të njohë mirë psikologjinë- e moshave të ndryshme të fëmijëve, që terapia të jetë e pranueshme dhe të mos refuzohet prej tyre. Duhet të jetë fizikisht i shëndetshëm dhe të përballojë ngarkesa fizike gjatë trajtimit të klientëve.

Fusha e veprimtarisë së tyre me të zakonshme është AK fizike dhe AK mendore-fizike.

### **Detyrat dhe Përgjegjësitë**

- Diagnostikon, realizon vlerësime të përshtatshme dhe ndërhyrje me fëmijë me spektër të gjerë nevojash për fizioterapi, duke përdorur mjete vlerësimi të përshtatshme dhe në përputhje me ICF-në.
- Në mënyrë të detajuar, fizioterapisti vlerëson funksionimin e PAK duke observuar atë në situata të ndryshme si dhe në ushtrime tip.
- Përcakton problemet me deformimet e kyçeve, anësive, kolonës dhe shkallen (gradacionin) e shmangjes apo deformimit.
- Përcakton tonusin muskular.
- Vlerëson aftësinë për të mbajtur ekuilibrin.
- Aftësohet për të kryer koordinimet sy-dore, dëgjim-levizje, lëvizje me lëvizje, etj.
- Aftësohet për të mbajtur ritmin.
- Organizon punën me PAK përherë në bashkëpunim të ngushtë me specialiste të tjerë të fushës si mjekë, neurologë, terapiste okupacionale, psikologe.
- Fizioterapisti plotëson raportin e nevojave motorike si dhe planin e kujdesit.
- Kryen ndërhyrje fizioterapie për fëmijët me spektër të gjerë çrregullimesh duke përfshirë të gjitha specialitetet pediatrike.
- Modelon punën, përfshin, udhëzon familjen mbi teknikat/aktivitetet kryesore fizioterapeutike me fëmijën e tyre.
- Merr pjesë në hartimin e planit personal të zhvillimit të fëmijës në bashkëpunim me ekipet dhe familjen e profesionistë të tjerë.
- Mban të dhënat për punën e kryer me fëmijën në mënyrë të qartë në përputhje me standardet e profesionit dhe kriteret e ICF-së.
- Formulon dhe ndjek/zbaton programe individuale trajtimi bazuar në informacionin e marrë nga vlerësimi i tij dhe ekipi.
- Kryen ndërhyrje trajtuese duke u përshtatur me barrierat dhe kushtet e vendit ku ndodhet fëmija, dinamikat e vetë fëmijës dhe familjes.
- Vlerëson ndërhyrjen e bërë dhe progresin e fëmijës përmes reflektimit, analizës dhe mjeteve objektive të dokumentuara me kujdes.

- Këshillon/edukon fëmijën dhe të tjerët si të menaxhojnë, minimizojnë riskun e dëmtimit të fëmijës (p.sh. gjatë lëvizjes) dhe si të parandalojnë e përmirësojnë gjendjen fizike të tij.
- Në bashkëpunim me ekipet shkëmben informacion për backgroundin dhe progresin e fëmijës si dhe referon tek shërbime komunitare fëmijët që kanë nevojë për vëmendje mjekësore që lidhet me këtë fushë.

### **Kualifikimet dhe Cilësitë e Punonjësit**

- Diplomë e nivelit master në fizioterapi;
- Të paktën 3 vite përvojë në profesion (prioritet përvojë në punën me fëmijët me aftësi të kufizuar);
- Te jete i licensuar per ushtrimin e profesionit te Fizioterapise;
- I aftë fizikisht dhe teknikisht të përshtasë trajtimin fizioterapeutik në mjedise/rrethana të vështira e me hapësira të vogla;
- Gëzon integritet individual dhe profesional si dhe pjekuri emocionale;
- Aftësi të mira planifikuese dhe organizative, negociuese dhe në zgjidhjen e konfliktit;
- Aftësi të mira interpersonale e i aftë të punojë me grupe të ndryshme njerëzish në mënyrë profesionale dhe etike;
- Ka respekt për të drejtat themelore, dinjitetin e fëmijës dhe familjes;
- Ka pasion për punën dhe ndihmën ndaj njeriut;
- Njohuri të mira për të drejtat e fëmijës dhe çështje të mbrojtjes së fëmijës;
- Njohuri/përvojë/trajtime mbi terapinë e sjelljes se aplikuar, terapinë e zhvillimit dhe te lojës (e preferueshme);
- Patentë të klasit B dhe të jetë i gatshëm të ngasë makinën (e preferuar).

### **Kushtet e Punës**

#### *Vendi dhe koha e punës*

Punonjësi do të punojë në bashkinë Prrrenjas pranë qendrës komunitare . Në përputhje me Kodin e Punës, java e tij e punës është 40 orë, nga dita e hënë në të premte.

80% e kohës së punës do të jenë duke ofruar terapi në qender dhe 20% në në aktivitete të tjera në funksion të përmbushjes së detyrës.

*Kohezgjatja e kontratës: 22 muaj*

*Data e synuar per fillimin e punes: 1 Tetor 2022*

#### *Sfidat e pozicionit të punës*

Punonjësi në këtë pozicion pune do të punojë me fëmijë dhe familje që paraqesin vështirësi/sfida të ndryshme ndaj është e nevojshme të dijë të krijojë marrëdhënie pozitive profesionale me të gjithë përdoruesit/përfituesit e shërbimit të të gjitha moshave, të jetë personalitet i duruar e i kujdesshëm, si dhe të dijë të aplikojë aftësitë e tij në zgjidhjen e problemeve dhe situatave të paparashikuara.

#### *Kontaktet dhe ndërveprimi*

Punonjësi në këtë pozicion pune, në përmbushje të detyrës së tij do të jetë në kontakt/ndërveprim të përditshëm me fëmijët /familjarët e fëmijës, kolegët e ekipit në qendër dhe atij lëvizës, profesioniste të tjerë të fushës dhe World Vision.

#### *Niveli i përgjegjësisë financiare*

Në këtë pozicion pune, punonjësi ka rol konsultues dhe raporton për nevojën e blerjeve dhe shpenzimeve të ndryshme në dobi të fëmijëve dhe familjeve tek personi përgjegjës.

### **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

Kandidati duhet të dërgoje me postë ose dorazi në Sektorin e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Prrenjas, dokumentet e dosjes së tij personale si më poshtë:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- CV;
- Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një Universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë atë të njëhsuar pranë Ministrisë përgjegjëse për Arsimin;
- Fotokopje e listës së notave. Nëse ka një diplomë dhe një listë notash të ndryshme me vleresimin e njohur në shtetin Shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë atë të konvertuar sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e librezës së punës;
- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Deklaratë me shkrim se kandidati nuk është denuar me vendim të formës së prerë nga gjykata dhe nuk ka qënë në ndjekje penale nga prokuroria;
- Vërtetim i gjendjes mjekësore.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në letrën e motivimit.

### **3. Logopedist me kohë të plotë**

#### **Qëllimi i Vendit të Punës**

Logopedisti në këtë vend pune është përgjegjës për dhënien e shërbimeve logopedike për fëmijët me aftësi të kufizuar në Qendren Komunitare. Ai do të vlerësojë, diagnostikojë, trajtojë si dhe do të ndihmojë për të parandaluar çrregullime të gjuhës dhe komunikimit tek fëmijët me aftësi të kufizuar në

komunitet. Ai do të kryejë një sërë aktivitetesh të dizenuara për të zhvilluar aftësitë para gjuhësore dhe gjuhësore, kontrollin oral-motorik për shprehjen e gjuhës, vokalizimet, si dhe përdorimin e teknologjive ndihmëse në ndihmë të komunikimit. Ai do të japë informacion dhe udhëzojë familjarët, kolegët e ekipit dhe entitete të tjera të interesuara mbi mënyrën, teknikat dhe aktivitetet logopedike ndaj fëmijës me aftësi të kufizuar.

Si logopedist i ekipit të qendrës komunitare ai do të kontribuojë në fushën e tij të përgjegjësisë për hartimin dhe ndjekjen e planit individual të fëmijës me aftësi të kufizuar dhe do të japë kontributin e tij në zhvillimin dhe promovimin e shërbimit të këtij ekipi.

### **Detyrat dhe Përgjegjësitë**

- Kryen vlerësime të detajuara përmes mjeteve/instrumenteve të përshtatshëm të nivelit të zhvillimit të gjuhës dhe komunikimit, në përputhje me ICF-në.
- Vlereson problemet në të folur dhe komunikim.
- Vlereson nivelin e dëgjimit dhe komunikimit.
- Vlereson nivelin e të kuptuarit nga fëmija të komandave apo mesazheve të thjeshta.
- Observon kohën që fëmija kërkon për të komunikuar apo përgjigjur.
- Observon problemet motorike të gojës, gjuhës dhe faqeve.
- Observon mënyrën se si fëmija bën kërkesa të ndryshme si dhe mënyrën si kundërshton apo revoltohet.
- Vezhgon cilësinë e të folurit, vendosjen e çrregullt të fonemave.
- Vezhgon problemet në nxjerrjen e zërit, intonacioni jo i rregullt.
- Belbezimi.
- Mban inventar të rregullt të të gjithë tingujve, rrokjeve, apo fjalëve-fjali që fëmija lëshon.
- Vlereson aftësinë e fëmijës për të kërkuar objekte të ndryshme.
- Vlereson aftësinë e fëmijës për të imituar tinguj, rrokje apo fjale.
- Vlereson përdorimin e gjuhës së trupit (xhestikulacione) të fëmijës.
- Vlereson aftësinë imituese të fëmijës në motorike globale, fine, bukofaciale, me objekte.
- Vlereson me shume kujdes marrëdhëniet ndërmjet nënës dhe fëmijës, apo kujdestarit.
- Vlereson nëse fëmija është në prani të personave që flasin gjuhë të pakuptueshme për të
- Vlereson nëse fëmija ka kaluar situata të rënda psikotraumatike që mund të kenë ndikuar në problemet e komunikimit.

- Jep/mundëson shërbime logopedike për një spektër të gjerë çrregullimesh/vështirësish duke përfshirë edhe fëmijët me nevoja komplekse (çrregullime në të nxënë, autizëm, etj).
- Harton dhe realizon programe terapeutike të individualizuara për nevojat e secilit fëmijë, në bazë të vlerësimit të kryer nga ai dhe ekipet .
- Këshillon dhe jep udhëzime për përdorimin e mjeteve ndihmëse dhe mjeteve të tjera terapeutike sa herë që është e nevojshme.
- Këshillon prindërit dhe të tjerë si të vazhdojnë terapinë dhe programin ndërhyrës në shtëpi.
- Bën raporte të detajuara të progresit të fëmijës (vetëm për fushën e tij të ndërhyrjes).
- Bashkëpunon me ekipet në hartimin dhe rishikimin e planit individual të zhvillimit të fëmijës e jep kontributin për fushën e tij të ekspertizës në këtë plan.

#### **Kualifikimet dhe Cilësitë e Punonjësit**

- Diplomë e nivelit master në degën e logopedisë.
- Te jete i licensuar për ushtrimin e profesionit të logopedisë.
- Të paktën 3 vite përvojë në profesion (prioritet përvojë në aftësinë e kufizuar).
- Integritet individual dhe profesional
- Aftësi të mira interpersonale e i aftë të punojë me grupe të ndryshme njerëzish
- Respekt për të drejtat themelore, dinjitetin e fëmijës dhe familjes.
- Njohuri të mira për të drejtat e fëmijës dhe çështje të mbrojtjes së fëmijës
- Aftësi të mira planifikuese dhe organizative, negociuese dhe në zgjidhjen e konfliktit
- Pasion për punën dhe ndihmën ndaj njeriut
- Komunikim profesional dhe etik
- Njohuri/përvojë/trajnime mbi terapinë e sjelljes së aplikuar, terapinë e zhvillimit dhe të lojës (e preferueshme)
- Patentë të klasit B dhe të jetë i gatshëm të ngasë makinën (e preferuar) .

#### **Kushtet e Punës**

##### *Vendi dhe koha e punës*

Punonjësi do të punojë në Bashkinë Prrrenjas pranë qendrës komunitare. Në përputhje me Kodin e Punës, java e tij e punës është 40 orë, nga dita e hënë në të premte.

80% e kohës së punës do të jenë duke ofruar terapi në qendër në 20% në aktivitete të tjera në funksion të përmbushjes së detyrës.

*Kohezgjatja e kontratës: 22 muaj*  
*Data e synuar per fillimin e punes: 1 Tetor 2022*

#### *Sfidat e pozicionit të punës*

Punonjësi në këtë pozicion pune do të punojë me fëmijë dhe familje që paraqesin vështirësi/sfida të ndryshme ndaj është e nevojshme të dijë të krijojë marrëdhënie pozitive profesionale me të gjithë përdoruesit/përfituesit e shërbimit të të gjitha moshave, të jetë personalitet i duruar e i kujdesshëm, si dhe të dijë të aplikojë aftësitë e tij në zgjidhjen e problemeve dhe situatave të paparashikuara.

#### *Kontaktet dhe ndërveprimi*

Punonjësi në këtë pozicion pune, në përmbushje të detyrës së tij do të jetë në kontakt/ndërveprim të përditshëm me fëmijët /familjarët e fëmijës, kolegët e ekipeve si dhe do të jetë në kontakt të vazhdueshëm me profesioniste të tjerë dhe World Vision.

#### *Niveli i përgjegjësisë financiare*

Në këtë pozicion pune, punonjësi ka rol konsultues dhe raporton për nevojën e blerjeve dhe shpenzimeve të ndryshme në dobi të fëmijëve dhe familjeve tek personi përgjegjës .

#### **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

Kandidati duhet të dërgoje me postë ose dorazi në Sektorin e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Prrrenjas, dokumentet e dosjes së tij personale si më poshtë:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- CV;
- Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një Universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë atë të njehsuar pranë Ministrisë përgjegjëse për Arsimin;
- Fotokopje e listës së notave. Nëse ka një diplomë dhe një listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në shtetin Shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë atë të konvertuar sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e librezës së punës;
- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Deklaratë me shkrim se kandidati nuk është denuar me vendim të formës së prerë nga gjykata dhe nuk ka qënë në ndjekje penale nga prokuroria;
- Vërtetim i gjendjes mjekësore.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në letrën e motivimit.

#### **2- Punonjës Social me kohë të plotë**

##### **Qëllimi i Vendit të Punës**

Punonjësi social në këtë vend pune është përgjegjës për dhënien e shërbimeve psiko sociale përmes vlerësimit të nevojave social-ekonomike, funksionimit dhe faktorëve riskues të fëmijës me aftësi të

kufizuara dhe familjes së tij. Në bazë të këtij vlerësimi ai mbështet fëmijën me aftësi të kufizuar dhe familjen e tij përmes aktiviteteve të tilla si: ndërmjetësimi, advokimi, koordinimi me institucionet dhe shërbimet, menaxhimi i dokumentacionit dhe dosjes së rastit, ngritjes së kapaciteteve të familjes dhe komunitetit në të cilin do të punojë.

Ai do të punojë si pjesë e ekipeve të specialisteve në qendër dhe atij lëvizës si dhe me profesionistë të tjerë në hartimin dhe zbatimin e planit individual të fëmijës si dhe ka rol kyç në hartimin dhe ndjekjen e planit të zhvillimit të familjes. Ai ka si përgjegjësi kryesore menaxhimin dhe koordinimin e të dy ekipeve, atij lëvizës dhe të qendres si dhe bashkërendimin dhe koordinimin e punës së ekipeve me shërbimet/institucionet e tjera në komunitet.

### **Detyrat dhe Përgjegjësitë**

- Kryen vlerësime të nevojave psiko sociale dhe ekonomike të rastit.
- Kryen vlerësime të kapaciteteve, funksionimit dhe zhvillimit të rastit (që përfshijnë kërkesat për mbështetje dhe pjesëmarrje, shtëpi dhe akomodim).
- Kryen vlerësime për matjen e riskut (p.sh. të dhunës dhe abuzimit në familje).
- Mbështet familjen e fëmijës me aftësi të kufizuar duke punuar direkt me familjen dhe persona të tjerë të rëndësishëm në jetën e fëmijës.
- Harton planin e zhvillimit personal të fëmijës në bashkëpunim me ekipet dhe profesionistë të tjerë.
- Harton planin e zhvillimit të familjes në bashkëpunim me ekipet dhe profesionistë të tjerë.
- Ndihmon në krijimin dhe mirëmbajtjen e dosjes personale të fëmijës me AK duke grumbulluar informacionin e duhur për ekuilibrin psikosocial.
- Punonjësi social implementon programe të planit të kujdesit si:
  1. Menaxhimin e sjelljeve të papranueshme.
  2. Rritjen e kapaciteteve informative në fusha të ndryshme
  3. Organizon dhe drejton tema sociale të rëndësishme për këto target grup
  4. Ndihmon personat me AK të eksplorojnë interesat e tyre, të zhvillojnë talentet dhe pavarësinë, të rrisin vetëvlerësimin dhe të mësojnë si të sillen me të tjerët në situata të ndryshme.
- Organizon dhe menaxhon aktivitete argëtuese që nxisin zhvillimin fizik, emocional, intelektual dhe social të PAK, si brenda institucionit dhe jashtë tij.

- Punon ne komunitet per te sensibilizuar opinionin publik per nevojat e personave me AK.
- Krijon rrjetin mbështetës per PAK ne komunitet duke vendosur marrdhenie mes ekipit lëvizës, atij ne qendër, kopshteve, shkollave , qendrave shendetesore, njësisë administrative, bashkisë dhe shërbimit social shtetëror.
- Harton planin e zhvillimit te familjes sebashku me ekipet dhe profesioniste te tjerë.
- Ben menaxhimin e rastit dhe koordinimin e shërbimit ne përputhje me kriteret dhe kërkesat ligjore.

Kryen shërbime ndërmjetësimi e referon fëmijën/familjen në shërbime të tjera.

- Mban dhe menaxhon dokumentacionin dhe dosjen e rastit.
- Jep mbështetje në koordinim dhe bashkërendim të punës së ekipit lëvizës dhe ekipit te qendres.
- Jep ndihmë në çështjet e strehimit, ndihmës ekonomike dhe çështje të tjera të ngjashme në dobi të familjes së fëmijës me aftësi të kufizuara.
- Advokon për fëmijën dhe familjen. Mbështet individët të jenë vetë advokues ose advokon në emër të tyre.
- Ngre kapacitetet përmes përfshirjes, edukimit dhe konsultimit me grupet lokale në komunitet, rrjetet, bizneset dhe qeverisjen lokale për të zhvilluar komunitete më përfshirëse për fëmijët/individët me aftësi të kufizuar duke hequr barrierat që pengojnë aksesin fizik dhe social.
- Ngre kapacitetet përmes punës me shërbimet në komunitet duke rritur ndërgjegjësimin, të kuptuarin dhe dijen për çështje të aftësisë së kufizuar dhe familjeve të tyre në mënyrë që shërbimet e përshtatshme dhe efektive të jepen në kohë.
- Ngre kapacitetet e individëve dhe familjeve për të naviguar në sistemet shëndetësore dhe të mirëqenies apo akses në informacion.
- Formulon deklarata/raporte të nevojave dhe e ndan këtë informacion me persona të përshtatshëm (agjensi, institucione, qendra, grupe multidisiplinare).

### **Kualifikimet dhe Cilësitë e Punonjësit**

- Diplomë e nivelit master në degën e punës sociale.
- Të paktën 3 vite përvojë në profesion (prioritet përvojë në shërbimet sociale për aftësinë e kufizuar).
- Të jetë i licënsuar nga Urdhri i Punonjësit Social.
- Të ketë njohuri bazë për të kuptuar dhe ndjekur procedura dhe procese të shërbimeve sociale.

- Të ketë aftësi të mira për të shkruar raporte të një standardi të mirë.
- Gëzon integritet individual dhe profesional si dhe pjekuri emocionale
- Aftësi të mira planifikuese dhe organizative, negociuese dhe në zgjidhjen e konfliktit
- Aftësi të mira interpersonale e i aftë të punojë me grupe të ndryshme njerëzish në mënyrë profesionale dhe etike
- Ka respekt për të drejtat themelore, dinjitetin e fëmijës dhe familjes
- Ka pasion për punën dhe ndihmën ndaj njeriut
- Njohuri të mira për të drejtat e fëmijës dhe çështje të mbrojtjes së fëmijës.
- Njohuri/pervoje/trajnime mbi Terapine e sjelljes se Aplikuar, Terapine e Zhvillimit dhe te Lojes (e preferueshme).
- Patentë të klasit B dhe të jetë i gatshëm të ngasë makinën (e preferuar) .

## **Kushtet e Punës**

### *Vendi dhe koha e punës*

Punonjësi do të punojë në Bashkinë Prrrenjasit ne ambientet e qendrës komunitare . Në përputhje me Kodin e Punës, java e tij e punës është 40 orë, nga dita e hënë në të premte.

30% e kohës së punës do të jenë në terren (në familje, institucione/shkolla dhe 70% në qender dhe në aktivitete të tjera në funksion të përmbushjes së detyrës.

*Kohezgjatja e kontratës: 22 muaj*

*Data e synuar per fillimin e punes: 1 Tetor 2022*

### *Sfidat e pozicionit të punës*

Punonjësi në këtë pozicion pune do të punojë me fëmijë dhe familje që paraqesin vështirësi/sfida të ndryshme ndaj është e nevojshme të dijë të krijojë marrëdhënie pozitive profesionale me të gjithë përdoruesit/përfituesit e shërbimit të të gjitha moshave, të jetë personalitet i duruar e i kujdesshëm, si dhe të dijë të aplikojë aftësitë e tij në zgjidhjen e problemeve dhe situatave të paparashikuara.

### *Kontaktet dhe ndërveprimi*

Punonjësi në këtë pozicion pune, në përmbushje të detyrës së tij do të jetë në kontakt/ndërveprim me fëmijët /familjarët e fëmijës, kolegët e ekipeve, përfaqësuesit e institucioneve si dhe do të jetë në kontakt të vazhdueshëm me World Vision.

### *Niveli i përgjegjësisë financiare*

Në këtë pozicion pune, punonjësi ka rol konsultues dhe raporton për nevojën e blerjeve dhe shpenzimeve të ndryshme në dobi të fëmijëve dhe familjeve tek personi përgjegjës.

## **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

Kandidati duhet të dërgoje me postë ose dorazi në Sektorin e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Prrrenjas, dokumentet e dosjes së tij personale si më poshtë:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;

- CV;
- Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një Universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë atë të njehsuar pranë Ministrisë përgjegjëse për Arsimin;
- Fotokopje e listës së notave. Nëse ka një diplomë dhe një listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në shtetin Shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë atë të konvertuar sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e librezës së punës;
- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Deklaratë me shkrim se kandidati nuk është denuar me vendim të formës së prerë nga gjykata dhe nuk ka qënë në ndjekje penale nga prokuroria;
- Vërtetim i gjendjes mjekësore.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në letrën e motivimit.

Dokumentacioni i kërkuar duhet të dorëzohet nga kandidati me postë ose drejtperdrejtë në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Bashkia Prrrenjas deri në datën **12.09.2022**.

Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni në adresën Bashkia Prrrenjas, Rruga "Skenderbeu", godina 15.

